

YLLJET ALIÇKA
VALSI I LUMTURISË
ROMAN

BOTIMET TOENA

YLLJET ALIÇKA

Valsi
i lumturisë

Roman

Ribotim

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Korrektore: Majlinda Toçi
Përkujdesja grafike: Erdita Oshafi
Kopertina: Lavdie Cenmurati

ISBN 9789928817457

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.
Kutia Postare 1420
E-mail: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al/>

*Ky roman u frymëzua nga ngjarje reale.
Çdo ngjashmëri me personazhe konkretë është e rastit.*

Kapitulli 1

Nga gjashtë pjesëtarët e familjes Tota, me biografi jo të mirë politike, vetëm dy mundën të marrin leje për të shprehur dhimbjen e tyre në ceremoninë e varrimit, organizuar me rastin e vdekjes së Enver Hoxhës.

Këtë të drejtë e fitoi motra e madhe, Elena, dhe vëllai i vogël, Simon, ndërsa motrave Irena, Ileana dhe Maria iu refuzua pjesëmarrja, pasi e qara e tyre u konsiderua e panevojshme.

Irenës ia kushtëzoi lejen e pjesëmarrjes në funeral Sekretari i Partisë së Ndërmarrjes së Elektrikut, me kusht që ajo të pranonte të dilte në punë edhe pasditeve vonë, së bashku me të, “vetëm sa për të tejkaluar planin e këtij muaji”.

Irena nuk doli pasditeve me Sekretarin e Partisë dhe të nesërmen dy punëtorë vunë, pra, në vendit të saj të punës afishen luftarake: “Armiku më i rrezikshëm është armiku që harrohet”. Aludimi për prejardhjen jo të mirë politike të Irenës bënte mû

dhe atë nuk e lejuan të merrte pjesë në funeral. Prej asaj dite, shokët e punës nisën t'i shmangeshin shoqërisë me të.

- Ruajna Perëndi, të flirtoj me një barkderr, vetëm e vetëm që të më lejojë të qaj për diktatorin, - iu qa ajo të motrave. - Të ma ndotnin kësisoj dhe të bërit dashuri!!!

Në Ndërmarrjen e Bulmetit ku punonte, Ileanës nuk iu dha ndonjë arsytim për refuzimin, ndërsa Mariës në Fabrikën Artistike i thanë përmbledhtas se “ju mungon biografia e mjaftueshme për funeral”.

- Me atë biografi që ke, as mos të të shkojë mendja për një gjë të tillë. E kupton vetë, - i deklaroi hapur Sekretari i Partisë.

- E kuptova, - i ishte përgjigjur Maria, dhe vendosi të mos shkelë më në atë vend pune.

Vëllai i madh, Vangjeli, nuk mori mundimin të bënte kërkesë për pjesëmarrje në funeral, kur sillte ndër mend poshtërimin që i bënë në funeralin e mëparshëm të vdekjes së një udhëheqësi tjetër të Partisë, shokut Hysni; atëherë, pra, kur vetë drejtori i Ndërmarrjes së Lëkurë-Këpucëve, ku punonte Vangjeli, i dha të drejtë që edhe ai, si gjithë shokët e tij, të shprehte me dinjitet hidhërimin e tij për humbjen e udhëheqësit.

Por, më pas ndodhi që mu në mes të Varrezave të Dëshmorëve, në kuadratin e Ndërmarrjes së Lëkurë-Këpucëve, ku Vangjeli kishte zënë vend mes shokëve të ndërmarrjes, për shkak të qafës së tij të gjatë, atë e

kishte pikasur Sekretari i Partisë, i cili menjëherë i kishte pëshpëritur në vesh kryetarit të Bashkimeve Profesionale:

- Ky është kulmi, të pranojmë edhe lotët e tyre për udhëheqësit tanë. Jo, deri këtu, jo!

- Nuk e solla unë, lejen ia dha tjetërkush, - u mbrojt kryetari i Bashkimeve Profesionale.

- Cili? - pyeti Sekretari i Partisë.

- Domethënë jo unë... desha t'ju them se ia dha drejtori i ndërmarrjes.

- Aha, dakord, do habitesha po të kishte bërë të kundërtën, por tani për tani ma hiq sysh atë shalëgjatin.

- Po si t'i them? - pyeti i hutuar kryetari i Bashkimeve Profesionale.

- T'i thuhet e vërteta: Udhëheqësi i lartë i Partisë nuk ka nevojë për lotët e tu. Kurseji lotët kur të vdesë ndonjë borgjez apo *pipino* fashist, kështu i thuaj!

- Të lutem shoku Vangjel, - iu drejtua kryetari i Bashkimeve Profesionale me butësi Vangjelit, - përpiqu të më kuptosh, këtë herë... pra, thjesht duhet të largohesh, asgjë tjetër...

- Çfarë?! - parandjeu Vangjeli rrezikun. - Për çfarë e keni fjalën?

- Thjesht, e kam fjalën që të përpiqesh të më kuptosh.

- Jo, unë nuk e kuptoj, - ia preu Vangjeli, duke u dridhur.

- Kurse unë e kuptoj fare mirë gjendjen tënde shpirtërore, dhembjen për vdekjen e shokut Hysni.

Por ndoshta është më mirë të gjesh ndonjë shkak të shokët e repartit, p.sh. sikur ke harruar çezmat hapur në shtëpi, a ku ta di unë...

- Aha, pse duhet ta bëj këtë gjë? Kur as ujë, as drita, s'kam harruar hapur. Pse? Mua ma dha lejen vetë drejtori i ndërmarrjes, - rezistoi Vangjeli.

- Dakord, dakord, - u ftoh zëri i kryetarit, - si të të them, s'është vendi këtu për të të kujtuar se Partia është mbi të gjitha. Kështu pra, tani duhet të largohesh. Hajde... gjeji një pretekst shokëve dhe shihemi nesër në ndërmarrje. Përpiqu të kuptosh drejt, kam dhe unë përgjegjësitë e mia.

- Çfarë përgjegjësie, unë s'paskam të drejtë të shpreh hidhërimin tim për shokun Hysni?

- Ashtu është, po ti shumë mirë mund ta shprehësh hidhërimin tënd aty, në shtëpi. Është pothuaj e njëjta gjë, rëndësi ka pikëllimi që ti ndien. Dhe, ja ku po të premtoj se në rastin e parë të ndonjë vdekjeje tjetër... desha të them të humbjes së ndonjë udhëheqësi tjetër të Partisë e të popullit, në funeralet e ardhshme, do të dal unë garant që të marrësh pjesë. Të jap fjalën!

- E pse u dashka të pres unë një vdekje tjetër, kur ja ku kemi këtë të sotmen?! Këtë s'e kuptoj unë.

- Aha, këtë s'e kuptoke dot ti?! - ia preu përgjegjësi i Bashkimeve Profesionale, - atëherë po më detyron të të them se ky është urdhër Partie dhe kaq.

Pas këtyre fjalëve, Vangjeli e mbylli gojën, bindi veten se nuk kishte nevojë të pikëlluhej për kaq gjë

dhe u largua kokulur, nën vështrimin e habitur të shokëve të Ndërmarrjes së Lëkurë-Këpucëve.

Binte shi dhe ashtu, vetmitar, Vangjeli zbriti natyrshëm, aq sa munda, Rrugën e Brigadave në drejtim të kundërt me turmat e njerëzve, që ngjiteshin për në varreza dhe shikonin me përçmim dikë që po braktiste funeralin e udhëheqësit të Partisë.

Mbërriti në shtëpi i njomur nga shiu monoton, i mërmëriti “mirëdita” motrave që rrinin pranë sobës dhe ashtu, i pushtuar nga melankolia, bëri të futej në dhomën e vet.

- Kaq shpejt mbaroi? - e pyeti motra e madhe, Leni, të cilës vëllezërit i hapnin rrugë sa herë që merrte fjalën.

- Nga ta di unë, - u përgjigj Vangjeli kokulur.

- Si nga ta dish? Nuk ishe në funeral?

- Jo.

- Pse?

- Se më përzunë.

- Cili? Ti more leje.

- Mora, po vetëm nga drejtori i ndërmarrjes.

- E çfarë pastaj?

- S'paskësh qenë e mjaftueshme. Më përzuri ai pushti i Partisë, mu para futjes së arkivolit në dhë.

- Po ti ç'i the? S'reagove?

- I thashë që kam marrë leje te drejtori, por ai më premtoi që të mos bëhem merak, se në funeralin e parë që do të vijë, do të bëjë çmos të më fusë ndër të parët në listë. Domethënë prit gomar të mbijë bar...

- Nuk është tamam ashtu, - ndërhyri Ileana, me flokët e mbledhur me bikutina alumini, - në fund të fundit kjo s'është gjë e vogël. Byroja politike është mbushur me pleq, me ditë e kanë, nëse të ka premtuar për të ardhmen, ç'e vret mendjen...

- As që më merr më malli, le të vdesë kush të dojë. Më mirë bëj një ditë pushim, se të shkoj e të qaj si hipokrit. Rri dëgjoj radion për qejf tim. He, he, he.

- Thuaj shyqyr, - psherëtiu Leni, - të paktën familja jonë përfaqësohet në funeral me Simonin. Përderisa po vonohet, do të thotë se s'e ka kthyer njeri mbrapsht.

- As që dua ta di, - foli plot kurajë Vangjeli dhe u fut në dhomën e tij.

- Po, po, s'do t'ia dish, po të është bërë surrati dy gisht! - tha Maria me t'u larguar i vëllai.

Duhet thënë se Vangjeli nuk u tregua krejtësisht i sinqertë me të motrat, pasi pas përvojës së hidhur me funeralin e Hysni Kapos, në rastin e vdekjes së Enver Hoxhës, ai u mobilizua me gjithë shpirt ta meritonte pjesëmarrjen në funeral, duke shfaqur në mënyrë korrekte tërë shenjat përkatëse të dhembjes.

- Kësaj radhe, nuk bëhet shaka, - i pëshpëriti atë ditë në vesh Shabani i Repartit të Shollës. - Edhe bufi e di se nga mënyra e shprehjes së dhembjes, pra e të qarit, çdo njeri shpreh sinqerisht ndjenjat e tij, dua të them simpatinë, apo antipatinë për regjimin.

- Ç' do të thuash me këtë? - e pyeti Vangjeli.

- Dua të them, kujdes me lotët, se nuk ka vetëm një njeri që do të na ruajë, domethënë do të mbajë shënim sa pika lot do rrjedhin nga sytë tanë.

- Kuptova, - u solidarizua Vangjeli. - Mos u bëj merak, kur e lyp puna, unë di të qaj me gjithë shpirt.

Ditën kur u komunikua vdekja e Udhëheqësit, i gjithë personeli punonjës i Fabrikës së Lëkurë-Këpucëve, ku punonte Vangjeli, reagoi korrektësisht në lidhje me dhembjen. Pati qarje masive si në mbledhjen solemne, ashtu edhe nëpër reparte, gjë që, sipas informatorëve përkatës të shërbimeve sekrete, “dëshmoi për gjendjen e mirë moralo-politike të kolektivit të Lëkurë-Këpucëve”.

Një gjë e tillë binte qartë në sy dhe nga shënimet e hollësishme të spiunit të Repartit të Tutkallit, ku punonte Vangjeli.

“Sot, kolektivi i Repartit të Tutkallit nuk po e beson gjëmën, - shkruante informatori në raportin e tij, - d.m.th. nuk po arrin të mësohet dot me humbjen e Komandantit. Pjesa dërrmuese e repartit nuk e pranojnë vdekjen, prandaj dhe thonë: “Jo! Ai nuk ka vdekur. Ai s’ka ditë vdekjeje, por vetëm ditë të lindjes. Kjo gjë nuk mund të ndodhë kurrsesi.”

Kurse ata që e pranojnë, pra, që ia dalin ta besojnë vdekjen e Komandantit, - vazhdonte raporti, - thonë: “O vdekje, pse s’më more mua dhe fëmijët e mi, po more Atë?!”. Në dukje mirë qau edhe punëtori i

ngjitjes me tutkall, Vangjel T., i njohur për biografinë e tij të dyshimtë. Sidoqoftë, unë thashë pjesa dërrmuese dhe jo të gjithë punonjësit, - sqaronte spiuni në raportin e tij, - pasi konstatova mjaft raste të njerëzve që nuk lëshuan asnjë pikë loti, apo që bënë sikur qanin, duke e detyruar veten nga frika.

Dhe, më konkretisht, atë ditë kur mbërriti lajmi i zi, kolektivi ynë ishte në sallën e mbledhjeve për analizën e zakonshme të mëngjesit, kur u hap dera me vrik dhe nëpunësi i rojës iu avit Sekretarit të Partisë së ndërmarrjes dhe diç i pëshpëriti në vesh. Sekretari ngriu në vend dhe mori qëndrim gatitu. Më pas, ai iu drejtua kolektivit me këto fjalë:

- Shokë, vëllezër... Komandanti vdiq, - dhe vuri duart në kokë duke ia marrë vajit me tërsëllëm.

Kolektivi u shtang, pa e kuptuar mirë ç'kishte ndodhur.

Më pas, Sekretari u gëlltit fort dhe bëri një tjetër përpjekje të mundimshme për t'u shprehur:

- Shokë... vëllezër..., - por dënesat nuk e lanë të nxirrte dufin e shpirtit. Atëherë, drejtori i vajti pranë dhe e shkundi nga shpatullat.

- Mbahu fort, - i tha, - jemi komunistë!

Paskëtaj, Sekretari i Partisë shfryu hundët fort me shami dhe, pasi qëroi fytyrën, na u drejtua solemnisht:

- Historia... po më ngarkon sot me një barrë të rëndë për shpirtin tim të lënduar, pra, t'ju komunikoj ju të gjithëve vdekjen e... e... Komandantit tonë legjendar... shokut Enver.

Në fillim, askush nga kolektivi nuk bëri ndonjë përpjekje të dukshme për të qarë. Këtu kam parasysh edhe komunistët e Repartit të Tutkallit me drejtorin në krye, që nuk po nxirrnin pikë loti.

Vetëm kur Sekretari i Partisë u shkri përsëri në vaj, u dëgjuan dënesat e para të kolektivit. Dhe atëherë, kur në ngashërim e sipër Sekretari i Partisë ktheu kokën nga drejtori, që deri atëherë kishte mbetur pa derdhur një pikë lot, atëherë drejtori duket e nuhati kuptimin e vështrimit të Sekretarit të Partisë dhe, pasi nxori edhe ai një shami, filloi të ngashërehej thellësisht i pikëlluar.

Ishte pikërisht ky, çasti kur vëmendja e kolektivit u drejtua nga drejtori. Por ndoshta kjo bëri atë që Sekretari i Partisë t'i thellonte më shumë dënesat. Këtu u duk qartazi se drejtori vendosi të mos mbetej shumë prapa në të qara, prandaj, nga ana e tij, lëshoi një kujë të fuqishme, ndjekur nga vështrimi i shastisur i Sekretarit të Partisë. Atëherë, këtij të fundit nuk i mbeti veçse të shpërthente në një vaj më të zhurmshëm e të gjatë, që i shkurajoi plotësisht të qarat e drejtorit, duke nxitur njëkohësisht të qara masive në gjirin e kolektivit tonë.

Sipas gjykimit tim, ishte pikërisht ky, çasti kur kolektivi kuptoi se duhej ndjekur shembulli i Sekretarit të Partisë dhe filloi kështu një garë fisnike të qarash. Kështu pra, qante drejtori dhe Sekretari i Partisë, qante në masë kolektivi ynë.

Veçse, në atë zallamahi, nuk ishte aspak e lehtë të kuptohej kush qante vërtet, apo kush fshihte fytyrën pas shamisë së hundëve.

Sipas mendimit tim, nuk mund të pretendohej më shumë nga Sekretari i Partisë dhe drejtori, të cilët vazhduan të qarat deri ku s'mbanin më, veç atij çasti kur Sekretari i Partisë dha shenja të përmbajtura lodhjeje, ai nxori shaminë dhe mbuloi krejt fytyrën me të, duke mos i lënë asnjë hapësirë drejtorit të ndërmarrjes për të marrë vesh nëse ai vazhdonte të qante ose jo.

Duket kjo mungesë transparence që e detyroi drejtorin të dorëzohej përfundimisht. Ai pa një herë me bisht të syrit nga Sekretari i Partisë me fytyrë të mbuluar, dhe më pas vendosi të rrinte ashtu i heshtur pa qarë, mu në mes të sallës. Kishte pamjen e një humbësi të madh. Mund dhe të thuhet se u bë për të ardhur keq. Vetëm kur nga altoparlantët e fuqishëm të ndërmarrjes u lexua komunikata e KQ-së së PPSH-së, Sekretari i Partisë dhe drejtori fshinë mirë e mirë sytë e hundët dhe morën qëndrim gatitu. Kolektivi bëri të njëjtën gjë.

Ndërkohë, Sekretari i Partisë e kishte mbledhur veten dhe pasi bëri një hap para drejtorit, lëshoi në adresë të kolektivit thirrjen kurajëdhënëse:

- Mbahuni fort, djema, dhe përpiquni ta shndërroni dhembjen në forcë! Ligjet e natyrës... nuk i luftojmë dot.

Krejt natyrshëm pas këtyre fjalëve, kolektivi i Repartit të Tutkallit ia rinisi me një shumëllojshmëri qarjesh dhe sjelljesh të tjera të ngjashme.

Të parës i ra të fikët F. M.-së, e cila kaloi në gjendje histerie. Kurse zv/sekretarja e Partisë P. K., e dalluar

për militantizmin e saj politik, u shtri në tokë dhe filloi të shkulte leshrat e gjata. Ajo u pasua menjëherë nga komunistja e flaktë L. M., e cila nuk i shkuli flokët e saj kaçurrela, por u shtri sa gjatë-gjerë në dysheme dhe filloi t'i binte kokës me grushte duke thënë:

- Korba unë, e zeza unë, korbët ne!

Dispeçeri i ndërmarrjes qau si burrat, pra, nuk lëshoi asnjë ofshamë gjatë gjithë kohës, lotët i rridhnin çurg e rrinte aty si shkëmb. Dukej sikur thoshte: "Burri nuk qan dhe e mban dhembjen. Por, në këtë rast, me gjithë përpjekjet e mia, ju po e shihni vëllezër, nuk mundem ta respektoj këtë zakon të lashtë të shqiptarit. Dhembje e tillë nuk pyetkërka për zakone burrërore, lotët iu bindkan veç gjëmës."

Ndërkohë, Vangjel T. kishte nxjerrë shaminë dhe bënte sikur fshinte sytë, duke parë sa majtas-djathtas. Ishte e vështirë të kuptoje ndonjë gjë nga emocionet e tij. Qëndronte i ngurtë, pa lëvizur as qerpikun.

Nuk qante as shefi i tij i repartit, veçse dukej haptas se dhembja e tij shprehej me dridhje të tmerrshme duarsh e gjunjësh, me gjithë përpjekjet e tij të mundimshme për t'i komanduar ato. Unë e pikasja që ai mbështeste fort duart mbi gjunjë për të ndaluar dridhjen, por gjunjët e tij pushonin pak për t'ia rinisur dridhjes më me vrull, vetëm pas dy-tri minutash.

Qau tmerrësisht shumë edhe Efigjeni e financës. Por kam të drejtën të them se të qarën e saj, unë e marr me shumë rezervë. Dhe ja pse: ka një muaj që Efigjenit i ka vdekur e bija dhe nuk resht së qari.

Pra, nuk mund të thuhet me siguri nëse e qara e saj është vazhdim i dhembjes për humbjen e së bijës, apo kishte motivin, pra nxitej, nga humbja e Udhëheqësit. Kjo, për vetë faktin se në qarjen e saj nuk dallova ndonjë ndryshim intensiteti lotësh apo nuance. Është e natyrshme që një nënë të qajë për humbjen e së bijës, por nuk më duket aspak normale të ngatërrosh të qarët, pra të qash për tjetërkënd e të shtiresh se po qan për Komandantin. Kuptuar kështu, ky rast përbën një burim të mëtejshëm ndjekjeje, për t'u verifikuar lehtësisht në të ardhmen, pra, do të shihet vazhdimësia e të qarave të saj.

- Pastruesen Semiha, - vazhdonte raportin e informatorit, - e dëgjova kur i pëshpëriti shoqes së saj mu në vesh: "U shyqyr, se kam kohë pa bo i dit' pushim. Do t'ia hyj shpisi me themel."

Kurse Atalanta qau vetëm një copë herë dhe më pas psherëtiu:

- Po mjaft qamë dé, do na bjerë të fiktit. S'do qajmë tërë ditën. Ai iku tani... S'e kthejmë dot më.

Nuk mund të thuhet me siguri se sa do të vazhdonin këto të qara, pasi për një çast ndërhyri përgjegjësi i tutkallit, i cili ftoi shaptilografisten pararojë, Lefterinë, të thoshte dy fjalë se "çfarë ndiente ajo në zemrën e saj në këto çaste".

- Qyqja, ku di unë çfarë të them, - reagoi e terrorizuar Lefteria, e kapur në befasi nga kjo kërkesë e papritur, - jo se s'ndiej dhembje, po nuk di unë e shkreta...

Por duket Lefteria e kuptoi shpejt se po shkelte në dërrasë të kalbur, pasi menjëherë i kërkoi ndihmë shoqes së vet me zë të ulët:

- Po, aman, më thuaj ndonjë fjalë, të keqen... se janë gjëra me zarar këto...

Përgjegjësi i repartit këmbënguli që ajo thjesht të thoshte atë që ndiente.

- Ça ndiej unë e shkreta, na dhemb sa s'bëhet, po ja, ku ta di unë... fundja më mirë jua shkruaj në letër, - tha kështu dhe i pëshpëriti shoqes së vet: - Fundja do t'i them gocës, e kam në gjimnaz, mos m'thotë a shkruaj ajo ndonjë gjë...

Shumë qau atë ditë edhe përgjegjësi i repartit të shollës, vazhdonte raporti, të cilin, për shkak të dellit të tij të njohur për të shkruar poezi të ndjera, e thërrasin "poeti".

Poeti, pra, qau fort dhe herë pas here deklamonte ndonjë fjalë prej poeti, domethënë me vjersha:

*"Këtë radhë gabove, o Enver, gabove rëndë,
Veç dije se populli yt është ende në këmbë..."*

Në fund, poeti e mbyll me dy vargje të ndjera "Shoku Enver vdiq. Vdiq Ai."

- Bah, poetët, ç'qenie të çuditshme! - dëgjova t'i pëshpëriste në vesh Lefteria shoqeve të saj.

Sefedini nga ana e tij ka qarë me hope, herë-herë bënte pushim, ndizte ndonjë cigare, e pas pak qante prapë.

Nga fundi asaj dite të zezë, e mori fjalën edhe magazinierja Fatime, që shpesh është dyshuar se vjedh shollë të cilësisë së parë. Duke u lëkundur nga shëndeti i tepërt, Fatimja bëri një hap përpara me këmbën e saj të shkurtër dhe tha plot ngashërim:

- Një herë, dhe vetëm një herë, s'na the të vërtetën, o Enver. Vdiqe e s'i the askujt. Po përse vdiqe?! Pse na e bëre këtë? Pse? E këtë nuk ta fal nëna.

Fillimisht, të gjithë ne aty besuam se bëhej fjalë për ato lloj pyetjesh që bëhen me të vetmen qëllim për të nxjerrë në pah mungesën e përgjigjes.

Por jo. Vetëm dy-tri sekonda më pas, ajo, Fatimja, pra magazinierja e Repartit të Shollës, e fali Udhëheqësin me këto fjalë:

- Po zemra e nënës është e madhe, o Enver. Po të fal, o Bir. Të fala se s'kam ç'bëj. Ty s'të mbaj dot mëri. Hallall! Hallall!

Pas këtyre fjalëve të fundit të Fatimes kolektivi lëshoi një psherëtimë lehtësimi.

Dhe atëherë kur u mendua se nuk kish më si të shprehej dhembja, Vangjeli i Repartit të Tutkallit, me duart e zërin që i dridheshin, gërthiti befas:

- Unë zotohem para jush se që nga kjo ditë mos vë gjë në gojë, pra... domethënë... bukë s'do vë në gojë gjersa të vdes, por normën do ta realizoj ama, se kështu na ka porositur shoku Enver.

Të gjithë ne që e njohim mirë kush është, e kuptuam se me këtë deklaratë hipokrite Vangjeli synonte të merrte ftesë në funeral. (Vetë Vangjeli ia

interpretoi më vonë të motrave se këtë deklaratë e kishte bërë me idenë për të aluduar mbi mungesën e ushqimit, demek “ne pa bukë se pa bukë jemi, të paktën të na e marrin se po e bëjmë nga dhembja” - shënim i autorit.)

Dhe së fundi, unë nuk mund të rri pa përmendur ditën e nesërme, kur kalova zyrë më zyrë me shiritin e zi prej mëndafshi që do lidhej te fotot e Udhëheqësit.

Në përgjithësi, njerëzit shkreheshin në dënosa sapo hyja unë me shiritin e zi në dorë. Ngriheshin menjëherë në këmbë, merrnin me kujdes shiritin dhe ashtu të dëshpëruar hipnin mbi karrige. Pati disa syresh, që dukej qartë se nuk dinin si ta lidhnin shiritin në formën e kordeles, prandaj, me mirësjellje, pyesnin:

- Po si lidhet? Ju lutem shumë...

Dhe unë ua shpjegoja me kujdes.

Ndërsa Vangjel Tota më tha:

- Unë s’hipi dot në karrige, pasi më merren mendtë, ju e dini, unë vuaj nga tensioni.

E pashë me neveri.

- Nuk mundem, - justifikohet ai, - ju lutem nuk mundem, se si më vjen, më bëhet sikur shikoj dy shirita.

Tha kështu dhe iu lut për ndihmë shoqes së repartit të vet, Landës, e cila tha se nuk mundej dot të hipte në karrige, pasi qenkësh me fund dhe s’desh “ta shihnin shokët e zyrës si në pasqyrë”.

Vetëm kur unë i hodha Vangjelit një tjetër vështrim kuptimplotë, atëherë, ai bëri sikur ngjiste disa shollë dhe më tha:

- Fundja, sa të mbaroj këtë punë që kam në dorë.
Mos u bëni merak, e lidh unë pas pesë minutash.

I dhashë përgjigjen e duhur aty për aty:

- Nuk jam unë në merak, por është në merak
Shqipëria, prandaj s' duhet të ishe shprehur ashtu.

Atëherë, ai u ngrit me vrik dhe nga vrulli desh ra
nga karrigia. Më pas, e pashë tek lidhte shiritin, por
të nesërmen shiriti nuk ishte më aty. E pyeta
Vangjelin për këtë gjë dhe ai m'u shfaqësua:

- Po vërtet, ç'u bë?! - por pas pak e gjeti poshtë
tavolinës. - Nuk e di për besë, paska rënë! - u shpreh
ky hipokrit i pashoq. - Bie vetë, nuk e di... unë e vë,
ajo të nesërmen bie... s' dua ta shtrëngoje shumë se
rrudhoset dhe i ikën hijeshia.

E vërteta është se më pas, shiriti nuk ra më dhe
unë e kuptova që ai e kishte ngjitur atë me tutkallin
e repartit. Kaq! Fund.”

Me këtë konstatim mbyllej raporti i informatorit
të Repartit të Shollës, ditën e vdekjes së Enver
Hoxhës.

Për këdo që do të lexonte këtë raport sekret, nuk
do të ishte e vështirë të kuptonte arsyen se pse
Vangjeli iu refuzua kërkesa për pjesëmarrje në
funeralin madhështor që organizohej pas pesë ditësh
zie.

Vangjeli i kërkoi kryetarit të Bashkimeve Profesionale
arsyen e refuzimit, për të marrë përgjigjen vetëm pas
disa orësh:

- Lot të pasinqertë dhe mungesë pasioni në shprehjen e dhembjes.

Vangjeli e priti refuzimin me dinjitet, pa e dhënë aspak veten në sytë e shokëve dhe u kthye në shtëpi më herët se zakonisht. Nisi të bënte ecejake nëpër dhoma duke ofsharë:

- Kësaj here më vjen... të ha veten me dhëmbë më vjen. Nuk është se më merr malli të dal nëpër shi e të bëj marshim deri te Varret e Dëshmorëve, por më vjen plasja se kam qarë korrektësisht...

- Ç'e vret mendjen, ti e bërë tënden me aq sa kishe në dorë, - e ngushëlloi motra Leni. - Të mos kishe nxjerrë asnjë pikë lot, atëherë po, ndoshta kishe të drejtë të mërzhiteshe. Rri, vëlla, rehat në shtëpi, bëj një ditë pushim, kthe një gotë... Ja dhe Irena, njëlloj si ti, por as që do t'ia dijë...

- Qau dhe ajo sa unë? - u bë Vangjeli papritur kureshtar.

- S'e besoj, - psherëtiu Leni, - veçse ky refuzim i fundit e ka dërmuar më keq.

Natën para funeralit madhështor, ashtu të mbledhur të gjithë në dhomën e ndenjjes, ajo shpërtheu në një krizë tjetër:

- Nuk duroj dot më, s'e di ç'na mbetet më në këtë jetë! Njerëzit më shmangen sikur të kisha zgjebe, dhe ato shoqe që kisha më janë larguar, prite kur të na gjejnë marifetin e të na fusin një nga një në burg.

- Nuk të kuptoj se ç'kërkon? - ia ktheu Leni qetësisht.

- Di këtë që nuk duroj dot më, o do më gjeni në psikiatri, o në fundin e ndonjë kanali. Unë nuk mundem më...

- Çfarë s'mundesh? - pyeti Vangjeli naiv.

- Nuk mundem më të jetoj, çfarë?!

- Po dhe mua nuk m'u dha leja, - e ngushëlloi Vangjeli, - dhe nuk bëj kështu. - Pa nga Simoni për të marrë miratimin e tij, por ai nuk tha gjë. Shikonte i heshtur televizor.

Ata nuk folën më dhe me pak imagjinatë mund të kuptohej jeta modeste e familjes Tota deri ditën e vdekjes së Enver Hoxhës, kur më shumë se gjysmës së familjes nuk iu dha leja për të qarë.

Familja Tota bartte statusin e familjes së deklasuar, që do të thotë se shihej me sy të keq politikisht, pasi në kohën e Luftës babai i tyre kishte studiuar në Itali për farmaci dhe gjatë pushtimit italian i kishte shitur ilaçe ushtarëve të plagosur italianë. Më pas, ai nuk ishte përzier me partizanë, apo ballistë, porse kujdesi i tepruar për shëndetin e ushtarëve italianë i kish mjaftuar të konsiderohej simpatizant i fashizmit, thënë ndryshe bashkëpunëtor i tyre, e të binte në burg, ku dhe pas ca vitesh kishte dhënë shpirt. Sipas të gjashtëve, kjo ishte arsyeja që ata mbetën pa martuar, me një jetë shpirtërore pothuaj të varfër, pa llogaritur këtu historinë e dashurisë së dështuar të Irenës së bukur, pas së cilës kishte rënë keqas në dashuri një inxhinier i Ndërmarrjes Elektrike, ku ajo punonte si teknike e mesme dhe pas vetëm gjashtë

muajsh të çmendur dashurie, inxhinierin e transferuan në një hidrocentral të largët “për zbutje të luftës së klasave”. Më pas, thjesht nga frika, ai nuk pranoi të takohej më me të, prandaj dhe Irena herë pas here binte në depresion.

Dhe Vangjeli, nga ana e tij, binte shpesh në dashuri, por motrat ia merrnin me rezervë tronditjet e tij shpirtërore, pasi në krye të javës ai bënte bé se kishte gjetur dashurinë e jetës me një vajzë të re. E vërteta është se nuk e kishin parë ndonjëherë të shoqërohej me ndonjë vajzë dhe motrat më shumë ishin të bindura se ai e kishte fjalën për dashuri platonike.

Motrës së madhe, Elenës, nuk iu mor vesh kurrë se ç’dridhje shpirtërore kaloi një periudhë kohe, gjatë së cilës u mbyll në vetvete, dhe me sytë e lotuar dëgjonte vetëm atë lloj muzike që prek ndjenjat. Thuhej se me të kishte rënë fort në dashuri një drejtues i rëndësishëm i sapokthyer nga një specializim nga jashtë. Por askush nuk mori vesh më shumë, pasi ajo kishte natyrë të fortë dhe nuk parapëlqente të hapej për jetën e saj intime.

Pasi kapërceu këtë kohë turbullimesh shpirtërore, Elena e kishte rimarrë veten dhe frenat e shtëpisë, pasi pas vdekjes së prindërve, falë karakterit të saj, pjesa tjetër e familjes e kishte pranuar si zërin autoritar për ruajtjen e ekuilibrit të brishtë familjar.

Ndërsa vëllai i vogël, Simoni, i cili dallohej për natyrën e tij fanatike karshi moralit të pastër, s’e

kishte gjetur ende vajzën që “do t’i garantonte besnikërinë e përjetshme bashkëshortore”.

Natyrisht që, asnjë prej fëmijëve të farmacistit nuk kishte pasur mundësi të ndiqte shkollat e larta, por me kohë ata kishin mundur të gjenin punëra të dorës së dytë: Vangjeli, punëtor në përpunimin e tutkallit në Ndërmarrjen e Lëkurë-Këpucëve, ku shfaqte zell të madh në tejkalimin e normës. Në vlerësimin që i bënte organizata e Partisë, shkruhej shkurt: “Vangjel Tota, punëtor i palodhur, por me sjellje të dyshimta”.

E vërteta është se, herë pas here, Vangjeli vidhte nga një kuti kanoçeje me tutkall, duke e fshehur atë pas xhepave të gjerë të kominosheve.

Vëllai tjetër, Simoni, punonte në sektorin e ngarkim-shkarkimit, domethënë hamall. Për shkak të biografisë, i kishin prerë në mes jo vetëm studimet, por edhe ëndrrën për t’u bërë kampion mundjeje dhe diplomat, pasi dy pasionet e tij në jetë ishin mundja dhe diplomacia. Që në fëmijëri, ai parapëlqente të zihej me shokët dhe natyrisht t’i mundte, ndërsa kohën e lirë e kalonte në Bibliotekën Kombëtare, ku lexonte traktatet e diplomacisë ndërkombëtare. Simoni kishte tipin e atij që sa herë e lyp puna, të marrë vendime të rëndësishme. Por po t’u besojë spiunëve të lagjes, ai kishte të gjitha shenjat e një “agjenti perëndimor të pazbuluar”. Kjo, natyrisht, nuk ishte e vërtetë, sado që vetë Simoni ofronte ndonjë sjellje të dyshimtë sa herë që merrte shkallët e drunjta dhe mu në mes të natës diç manovronte me sahatin

e elektrikut, kuptohet për të ulur faturën e konsumit të dritave.

Motra e madhe, Leni, punonte në qëndistari, ku nuk përzihej me askënd, por shoqet e respektonin nga larg, kurse motra më e vogël, Maria, për shkak të pasionit të saj për pikturën, punonte si disenjatore në një ndërmarrje artistike. Ishte vajzë në harmoni me veten dhe që s'krijonte shumë probleme në jetë. Në kohën e lirë, lexonte dhe bënte pikturë. Kishte mbetur e virgjër. Kjo, jo për shkak të ndonjë parimi të rreptë moral, siç i thoshte ajo të motrave, por “thjesht pasi s'i ishte paraqitur ndonjë rast i denjë për natyrën e saj”. Me një fjalë, për shkak të rrethanave.

Motra e tretë, Irena, vajzë e bukur, por kishte nerva të copëtuara. Punonte në një ndërmarrje elektrike, ku bënte normën dhe mbyllej në vetvete.

Dhe së fundi, Ileana, ëndërrimtarja e familjes, ishte kontrollore cilësie në Fabrikën e Bulmetit. Ileana kishte natyrën e atyre vajzave që nuk përzihen me meshkuj të rëndomtë, “pasi ata nuk janë në një nivel me të”, pra, nuk e meritonin vëmendjen e saj. Ishte në pritje të atij që do ta kuptonte me sinqeritet botën e saj shpirtërore e kulturore, por që natyrisht t'i përshtatej dhe në pamje sharmit të saj. Princi i kaltër vonohej mizorisht, por Ileana ishte vajzë e durueshme dhe, ashtu e bindur, që një ditë ai do t'ia behte ashtu papritur, përgatiste me pasion pajën e saj.

Pas pune, motrat mblidheshin në shtëpi, dëgjonin radion në stacione italiane dhe shpresonin më kot shembjen e regjimit, teksa vëllai i vogël, Simoni, vriste mendjen si të manipulonte pa lënë gjurmë aparatit e konsumit të elektrikut dhe atë të ujit. Veç guximit të madh (komshinjtë ishin gati të spiunonin sapo pikasnin një lëvizje të dyshimtë pranë aparatit), një ves i tillë kërkonte njohuritë e nevojshme teknike, të cilën Simoni e fitonte nga konsultimet me të motrën, Irenën, teknike e mesme elektriku.

- Aman se do na marrësh më qafë! - i lutej Vangjeli të vëllait, sapo e shihte që ai hidhte nga dritaret disa vështrime konspirative dhe nxirrte veglat e punës.

Ky qëndrim i Vangjelit vinte dhe për shkak se në dallim nga vëllai i vogël, i pajisur sipas tij me “guxim prej budallai”, ai nuk spikaste për ndonjë guxim të tepruar në jetë.

- Kështu e bëjnë të gjithë, - i përgjigjej Simoni dhe i kërkonte Vangjelit që në vend që të qurravitej pa pushim, t'i mbante më mirë shkallët se mos, gjatë kryerjes së operacionit të paligjshëm, kishte rrezik të binte në dysheme.

- Pse s'e kam kuptuar unë, - thoshte Simoni, duke hedhur shikimin nga shtëpia e komshiut, - edhe ai palo komunisti që çirret tërë ditën për mbrojtjen e pasurisë socialiste, me të kaluar dhjeta e natës, fik dritën dhe me qiri në dorë rri me orë tëra pranë sahatit të elektrikut. Mos e ka marrë malli të rrijë majë

shkallës për qejf?! Për të vjedhur korrentin e Partisë, për këtë rri. Mjaft, të lutem shumë, me moralizimet e tua!

- S'e kam për moral, - i kundërpërgjigjej Vangjeli, - për shkak të atij spiuni e kam fjalën dhe unë. Kjo buron nga vetë natyra e njeriut, - përpiqej ai t'i argumentonte të vëllait për të hequr dorë nga rruga e gabuar.

- Çfarë buroka nga natyra e njeriut? - pyeste Simoni i habitur.

- Ajo pra, që të marrë më qafë atë që kërkon të përfitojë më shumë se ai vetë.

Vetëkuptohet që ky argument nuk e bindte Simonin, pasi ai anonte më shumë nga parimi: "Si na e bëjnë, do t'ua bëjmë. Dy duar për një kokë janë."

Kapitulli 2

Natën e vigjiljes së funeralit të Udhëheqësit, ashtu të mbledhur më herët se zakonisht, pamja e gjashtë Totave ngjallte trishtim dhe linte shumë mbresa.

Motrat e mëdha dhe Vangjeli përpiqeshin t'i kthenin Irenës shijen e jetës, kurse Simoni rrinte i menduar aty në qoshe dhe godiste me gisht tavolinën prej druri.

- Pse s'flet? - e pyeti Elena Simonin.

- Sepse do të flas, apo më mirë do të veproj, atëherë kur duhet.

- Ç'kërkon të thuash? - këmbënguli Maria.

- Atë e di unë, - ia preu shkurt Simoni.

Për një njeri të pandjeshëm, kjo përgjigje do të kalonte pa u vënë re, por për Vangjelin, ashtu të pajisur me finesën e tij karakteristike, jo. Ai pyeti të vëllanë:

- Mos është e tepërt të të pyes se ç'kupton me: "E di unë se ç'duhet bërë"?

Por edhe përgjigjja e Simonit u bë me mjaft përkujdesje: